

11-25 LEKË NË DITË MË SHUMË

Përgjatë gjithë shtatorit, kryeministri Edi Rama ka shkumëzuar me një gjuhë sa urrejtje ndaj kritikave po aq edhe delirante ndaj vetëvetes kur thotë se ai, dhe vetëm ai, do të mund të rrisë pensionet dhe ta udhëheqë Shqipërinë drejt Bashkimit European. Kushdo tjetër është mashtues i mbi 700.000 pensionistëve të giorë, vota e të cilëve, sipas tij, është e lidhur përjetësisht pas Edi Ramës dhe Partisë Socialiste. Dhe pa kaluar as një javë nga poza autoritare prej udhëheqësi të padiskutueshëm, prej një pothuajse Mbreti, ai në të vërtetë i rriti pensionet. Plot 25 lekë pensionet e qytetit dhe përplot 11 lekë ata të fshatit. Ose 4.1%, siç përpiket ai dhe ministri i ri i ekonomisë Bledi Goxhja të fshihen pas një gjuhe korruptuese shifrash dhe statistikash. 4.1%, ose një kokërr vezë në ditë. Kaq arriti ti jepte kryeministri i "majtë", "transformues" dhe "evropian", shtresës më të varfër dhe të nëpërkëmbur të popullit shqiptar, pensionistëve. Pensionistëve, të cilët duhet ti kthejnë dorë dhe t'ia thyejnë turinjtë konsideratave të Edi Ramës për ta si masë fanatikësh prej qindra mijëra votash të sigurta në xhep. ■

***NJË PUNETOR PENSIONIST BIE
NGA SKELAT***

“Më datë 06.09.2024, në rrugën “Bardhok Biba”, dyshohet se, aksidentalisht duke punuar, është rrëzuar nga skela e një objekti në ndërtim e sipër, shtetasi V. B., 66 vjeç, i cili si pasojë e dëmtimeve të marra, ka ndërruar jetë në vendngjarje. Grupi hetimor po punon për sqarimin e rrethanave të ngjarjes”, njofton Policia e Shtetit me datë 6 shtator. Tri pyetje: si ka mundësi që një 66 vjeçar të bjerë nga skela kur ai do të duhej të ishte duke gëzuar daljen në pension?; si ka mundësi që policia e shtetit fsheh përherë emrin e viktimës dhe asnjëherë vazhdimin publik të hetimeve?; si ka mundësi që ajo përcakton rrugën dhe jo objektin nga ka rënë punëtori? Përgjigja është e thjeshtë: varfëria, korrupsioni dhe një shtet në shërbim të parasë së pisët, ku punëtorët dhe vdekja e tyre shihen si kosto normale të maksimalizimit të fitimeve të tyre. 14 punëtorë kanë vdekur gjatë këtij viti në kantierët e ndërtimit dhe asnjë masë serioze nuk është marrë deri më sot nga institucionet shtetërore. ■

FYERJET E NJË SKLLAVOPRONARI

Vullnet Sinaj, një nga shumë deputetët gjysëm-anonimë të Partisë Socialiste, oligark, i akuzuar shpesh për abuzime me të drejtat e punëtorëve dhe cilësisë së mallrave në rrjetin supermarketeve që ka në pronësi, u shpreh në Komisionin Parlamentar ku ai ishte i thirrur si i akuzuar për konflikt interesi në lidhje me shitjen e mallrave për institucionet publike drejtëpërsëdrejti nga bizneset e tij, se e "gjitha është një keqkuptim për shkak të punëtorëve injorantë që nuk lexojnë dhe nuk e dinë se çdo të thotë institucione publike". Këtë e tha, me ndjenjën e përzierë e të dukshme të sikletit, nënqeshjes dhe neverisë. Por le ti hedhim një sy listës së pagave të punëtorëve në supermarketet e tij ku bien në sy abuzimi me pagat e ulëta dhe pagesat nën pagën minimale. Mjafton ky fakt për të kursyer një mijë fjalë për këtë personazh tipik që përshkruan më së qarti "qeverisjen në kohën e Edi Ramës": edhe politikan i korruptuar, edhe biznesmen xhambaz, edhe një paragjykes i punëtorëve të vet. ■

[illegible]

Pagat në *Big Market*.

*KËRCËNIMI ËSHTË GJUHA E
DËSHTIMIT*


A thua se për 11 vjet ai ka qenë në opozitë dhe asnjë sekond në pushtet, në mbledhjen e Asamblesë Kombëtare të PS-s, Edi Rama deklaroi se: "Mund të them troç, rritja e të ardhurave nga shteti për pensionistët në vitet në vijim nuk mund të jetë domethënëse nëse nuk i japim të gjithë bashkë si shtet, qeveri dhe shoqëri si sipërmarrje një goditje domethënëse fenomenit të fshehjes së pagave që për paspojë godasin të ardhurat për sigurimet shoqërore dhe vjedhin çka u takon pensionistëve. E thënë me fjalë të tjera, do bëjmë me kuotat e sigurimeve atë që bëjmë me faturat e energjisë. Ata që s'u paguajnë sigurimet sipas pagës do i trajtojmë si hajdutët e energjisë elektrike". Këtu kemi dy probleme. E para, institucionet shtetërore të punës që janë ironikisht edhe më të dobëta ndër institucione publike, kanë mbyllur sytë përballë shkeljeve të Kodit të Punës, por dhe kur e kanë zbatuar atë, e kanë vënë në funksion të gjobave të klienteles apo reprezaljes politike. E dyta, ai përpjekje ta heqë fajin nga vetja për ta zbritur poshtë tek bizneset, a thua se nuk është përgjegjësia e tij të luftojë informalitetin dhe të zhvillojë politika punësuese. Por pagjegjshmëria më e rëndë është krahasimi me reformën në energjitikë, viktimat të së cilës qenë jo privatizuesit korruptivë të sektorit energjitik dhe abuzuesit e mëdhenj, por mijëra kryefamiljarë të varfër, shumë prej të cilëve u burgosën dhe disa madje edhe u vetëvranë në kushte të rënduara psikologjike. ■

Supported by Rosa Luxemburg Stiftung Southeast Europe with funds of the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ). This publication or parts of it can be used by others for free as long as they provide a proper reference to the original publication.

The content of the publication is the sole responsibility ICSE and does not necessarily reflect a position of RLS.

PSE GRATË PAGUHEN MË PAK SE BURRAT?

Sipas INSTAT, në vitin 2023, pabarazia në pagë midis burrave dhe grave që punojnë në të njëjtin sektor ose vend pune është rritur me 6.2%, përkundër tre viteve më parë, kur pabarazia ishte vetëm 4.5%. Gjithashtu nga 36 profesione, gratë mbizotërojnë në vetëm 5 prej tyre, kryesisht si politikanë, gjykatës ose drejtues kompanish të mëdha, ndërsa në 31 profesionet e tjera si industri, shërbime, madje edhe në rafshin e punës intelektuale, ato vazhdojnë të paguheshin më pak se meshkujt. Përveçse është totalisht absurde të paguhesh më pak për të njëjtën punë nisur nga paragjykimet gjinore, apo që shteti dhe shoqëria ende nuk e njeh punën e papaguar në shtëpi të gruas si amvisë, edukatore, kuzhinierë, sanitare etj, rritja e pabarazisë tregon se shoqëria jonë po bën hapa pas në çështjen e emancipimit gjinor pavarësisht feminizmit të rremë shtetëror dhe spektaklit televiziv me raste suksesi të grave në politikë dhe biznes. Sipas sondazheve, Edi Rama merr shumë vota nga gjinia femërore, por ligjet e tij janë maçiste dhe pro-burrave të fortë e të pandershëm. ■



Shifrat sipas *INSTAT*, përpunim i revistës *MONITOR*.

Vladimir Majakovski, poezia dhe karikaturat

Vladimir Majakovskij (1893 – 1930) ishte poet, karikaturist dhe qytetar rus me famë ndërkombëtare. Në botën letrare shqiptare ai njihet më së shumti për poezitë mbi dashurinë e tij tragjike, duke lënë në harresë faktin se ai ishte një nga autorët më avantgardistë të kulturës dhe futurizmit rus, përkrahës i revolucionit social të 1917, karikaturist politik dhe kritik i degjenerimit burokratik të shtetit të parë të punëtorëve në botë. Ishte pikërisht dashuria e tij tragjike dhe shpërhytyrimi i idealit revolucionar çka çoi në vetëvrasjen e tij me 14 prill 1930. ■



Me gjithë zërin

Vargu im do të vijë
Përmes kreshtave të shekujve
dhe përmes kokave
të poetëve dhe sundimtarëve.
Vargu im do të vijë
por do të vijë
jo si një shigjetë
gjuetie e Kupidit,
jo siç i vjen
nomizmatikut një monedhë e
veshur
dhe jo siç arrin drita e yjeve të
vdekur.
Vargu im
me mundim
do të çajë masivin e viteve
dhe do të shfaqet
bindës,
i vrazhdë,
i prekshëm,
siçshfaqet në ditët tona
ujësjellësi
i ndërtuar nga skllëvërit e Romës.




Liria e shprehjes

Natën e parë ata erdhën fshehtas
dhe këputën ca lule
në oborrin tonë.
Ne nuk thamë gjë.
Natën e dytë erdhën pa asnjë droje;
na shkulën lulet,
na vranë qenin...
Dhe ne prapë nuk thamë gjë.
Derisa një ditë,
në mesditë të një dite me diell,
na u futën në shtëpi si në punë të tyre,
na grabitën çfarë kishim më me vlerë;
sepse e njihnin frikën tonë,
që na e thau pështymën në gojë.
Dhe... meqë s'kishim thënë gjë,
ne përsëri,
nuk mund të thoshim gjë.

Përfundimi

Asgjë s'do ta fshijë dashurinë,
as grindjet
as kilometrat,
Është medituar
provuar,
kontrolluar.
Duke ngritur solemnisht vargjet,
gishta rreshtash,
betohem:
dua me një dashuri të pandry-
shueshme e besnike.



Porky është një personazh vizatimor i karikaturuar në 1920. Ai përfaqëson figurën e pronarit të paskrupullt, fytyra e të cilit reagon në mënyra të ndryshme ndaj veprimeve të punëtorëve. Ky personazh vazhdon të mbetet ikonik edhe në ditët e sotme nëpër rrjetet sociale, si një meme e hierakisë, abuzimit dhe rezistencës në vendin e punës. ■

Organizohu!

tel: 0692570076
e-mail: organizohu@gmail.com

NJË VEZË NË DITË



14 PUNËTORË TË RËNË NGA SKELAT KËTË VIT